



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria – Vlada - Government*

**Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health**  
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Pristine datë, 03.05.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **02.05.2024**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik Dreni Pharm, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizim me Barna nga Lista Esenciale” Lot 30** me Nr. të Prok: **206-24-582-1-1-1**, nxjerr:

**V E N D I M**

1. **REFUZOHET**, si e pa bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik **Dreni Pharm** e dt. 02.05.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Furnizim me Barna nga Lista Esenciale” Lot 30** me Nr. të Prok: **206-24-582-1-1-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK të datës 26.04.2024.
2. **Mbetet në fuqi**, Njoftimi mbi vendimin e AK, i datës 26.04.2024 për Lot 30;
3. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit për Lot 30;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-qov.net>.

**A r s y e t i m**

Operatori Ekonomik Dreni Pharm me datën 02.05.2024 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizim me Barna nga Lista Esenciale” Lot 30** me Nr. të Prok: **206-24-582-1-1-1**. AK-MSh, me datë 03.05.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankues:

AK ka bërë shkelje në LOTIN 30 për produktin Methylprednizolam pasi që në asnjërin MA nuk ceket doza e kërkuare në LE.

**Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

Nuk ka specifikuar.

### Dëmet materiale

Produkti I kompais Ciron Drugs&Pharmaceutical Pvt.ltd decidivishte e pershkruan produktin ne fjale si powder for solution for injection 40 mg ne shishe xhami prej 10ml edhe nje solvent ku nuk ceket se cfar ml eshte solvent. Ketu kemi te bejme se specifikacioni I lartepermendure eshte ne kundershitime me kerkesen e LE.

Produkti I kompais Welcure Remedies ne pershkrim te MA shkruan decidivisht vetem 40 mg ( nuk ceket se per sa ML eshte ) dhe nuk e pershkruane se a ka tretes.

Demet materjale jan te medhaja dhe kerkojme nga Ak te na kompezoj damin

### Përgjigjia e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore

Pretendimet e juaja ankimore i konsiderojme te pa bazuara, duke marre parasysh se produkti methylprednisolone i OE te rekomanduar e ka dozen 40mg siç eshte kerkuar ne tender dhe kjo eshte rikonfirmuar me sqarimet shtrese te dates 07.03.2024.

Eshte i pa bazuar pretendimi juaj se produkti i OE te rekomanduar eshte ne kundershitim me LE se e ka pershkrimin powder for solution for injection 40 mg ne shishe xhami prej 10ml edhe nje solvent ku nuk ceket se cfar ml eshte solvent.

Edhe produkti i ofertës tuaj është Powder and solvent for solution for injection 40 mg, Pack Size: 1 vial with powder+ 1 ampoules with solvent in carton box.

AK-MSh i ka besuar vlerësimit profesional te profesionisteve te farmacisë qe kane vlerësuar këtë aktivitet dhe qe kane rekomanduar për shpërblim me kontrate te ofertës se përgjegjshme me çmimin me te lirë, bazuar ne kriterin për dhënie te kontratës dhe duke respektuar LPP-ne, e sidomos nenin 1 te LPP-se për mbrojtjen e buxhetit.

Duke pasur parasysh se oferta e rekomanduar është me çmimin me te lirë prej 167650.56 euro, ndërsa oferta juaj është e treta me çmim prej 258660.86 euro, kemi te bëjmë me një dallim ne çmim prej 91,010.30 euro, qe është dallim substancial për këtë produkt, ndërkohë qe te dy OE keni ofertuar me produkte te prodhuesve me origjinë e nga INDIA.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

### Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit